“Në kohën e të Dërguarit të Allahut sadakanë e fitrit e jepnim për çdo të vogël e të madh, të lirë e rob, një saë ushqim, djathë, elb, hurma ose stafidhe

Ebu Seid Hudriu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: “Në kohën e të Dërguarit të Allahut sadakanë e fitrit e jepnim për çdo të vogël e të madh, të lirë e rob, një saë ushqim, djathë, elb, hurma ose stafidhe. Kështu, ne vazhduam ta japim, derisa erdhi Muavi ibn Ebu Sufjani (nga Shami) për haxh a umre, e në atë rast u foli njerëzve nga minberi dhe, në mes tjerash, atyre u tha: “Mendoj se dy palë grushte nga ky grurë i Shamit është i barabartë me një saë hurme.” Pastaj njerëzit vepruan sipas kësaj (fjale të Muaviut). Ebu Seidi tha: “Ndërsa unë do të vazhdoj ta jap ashtu siç e jepja për jetë, sa të jem gjallë.”

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Muslimanët në kohën e Profetit dhe në kohën e kalifëve të drejtë e jepnin sadakanë e fitrit për secilin person, të vogël apo të madh, nga një saë ushqim. Ushqimi i tyre ishte elbi, stafidhet, djathi dhe hurmat. Një saë është i barabartë me katër mudd, dhe një mudd është sa dy grushta të një personi mesatar. Kur Muaviu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) erdhi në Medinë si kalif dhe gruri i Shamit u bë i bollshëm, mbajti një fjalim dhe tha: "Unë shoh se dy mudd grurë nga Shami (gjysmë saë) janë të barabarta me një saë hurma." Pastaj njerëzit vepruan sipas kësaj (fjale të Muaviut). Ebu Seid Hudriu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tha: “Ndërsa unë do të vazhdoj ta jap ashtu siç e jepja në kohën e Profetit për jetë sa të jem gjallë.”

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/4454